



QENDRA KOMBËTARE TEKNIKE MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
 BIO-MJEKËSORE SHOQËRIA "ILLYRIAN GUARD" SHA

Nr. 1922/ Prot. 31/12/2025
 Tiranë, më 31/12/2025

Nr. 44/3 Prot. 31/12/2025
 Tiranë, më 31/12/2025

KONTRATË SHËRBIMI

Titulli i kontratës: Shërbim Sigurie për ruajtjen fizike të ndërtesave, asetëve dhe njerëzve të Qendras Kombëtare Teknike Bio-Mjekësore Tiranë me punonjës shërbimi dhe sistem vëzhgimi dhe sinjalizimi.

E lidhur me datë 31.12.25 ndërmjet palëve:

Qendra Kombëtare Teknike Bio-Mjekësore Tiranë, me adresë: Rruga "Dibrës", Nr.12, Tiranë, me NIPT K51731023B, përfaqësuar nga **Z. Luan Kola** në cilësinë e Drejtorit, tani e tutje të referuar si "Përfutues i Shërbimit"

Dhe

Shoqëria "Illyrian Guard" SHA, me adresë: Rr "Ibrahim Rugova", Ish Garda Republikës Shqiptarë, Tiranë, e cila është e organizuar dhe ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin Shqiptar e Regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit me numër identifikimi NIPT: L91619024U, me numër licence LN-7531-06-2019 për "Sigurimin fizik të objekteve shtetërore e private, të personave, si dhe veprimtarive social-kulturore, sportive, fetare e politike", përfaqësuar nga Administratori **Z. Enrik BANUSHI**, tani e tutje të referuar si **Ofruesi i Shërbimit**.

Referuar dispozitave të Kodit Civil të RSH, bazuar në Ligjin Nr. 75/2014 "Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike" i ndryshuar, Ligji Nr.10 296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin ", Udhëzimi Nr.150 datë 16.08.2024 të Ministrit të Brendshëm "Për funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike", VKM-së Nr. 177, datë 04.04.2019 "Për kryimin e Shogërisë "Illyrian Guard" SHA, Udhëzimin e Përbashkët të Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr. 90, datë 27.06.2023 si dhe aktet specifikuar në kushtet e përcaktuara në:

- Këtë Formular Kontrate
- Kushtet e Përgjithshme të Kontratës
- Kushtet e Vecanta të Kontratës
- Formularin e Përgjegjësisë Profesionale





**QENDRA KOMBËTARE TEKNIKE
BIO-MJEKËSORE TIRANË**

– Rregulloren e Përbashkët të Sigurisë

– Aneks Nr. 1 Tabela e objekteve ku ofrohet shërbimi për Qendra Kombëtare Teknike

Bio-Mjekësore Tiranë dhe Rregulloren e Përbashkët e Sigurisë së Objektivit

– Aneks Nr. 2 për Mbrojtjen e të dhënave personale

– Aneks Nr. 3 “Skema e Sigurisë së Objektivit”

– Aneks Nr. 4 Proces Verballi i martesës së objekteve në dorezim me fillimin e zbatimit të

kësaj kontrate

– Aneks Nr. 5 Procesverbal mujor i realizimit të shërbimit

– Aneks Nr. 6 Amendim kontrate (në gdo kohë që palet bien dakord)

Të gjitha këto dokumente të bashkëlidhura, janë pjesë integrale e kësaj Kontrate.

1. Ofruesi i Shërbimit duhet të paraqesë një formular të përgjegjësisë profesionale të lëshuar

nga një institucion financiar (kompani sigurimi ose bankë). Ky formular do të ketë vlerë

dhe do të jetë i pandryshueshëm gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës.

2. Ofruesi i Shërbimit është i detyruar të kryejë shërbimet për subjektin përfitues të

shërbimit, sig kërkohej në këtë Kontratë.

3. Subjekti Përfitues i shërbimit është i detyruar të paguajë për shërbimet e kryera, në

shumën e parashikuar në këtë Kontratë.

4. Në këtë Formular Kontrate, fjalët dhe shprehjet do të kenë të njëjtin kuptim që i ngarkohet

atyre në Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

5. Palet e kësaj Kontrate kanë përgjegjësi për moszbatim ose zbatim të papërshtatshëm të

detyrimeve të tyre kontraktore dhe për dëmet e shkaktuara secilës nga moszbatimi i

detyrimeve, që janë subjekt kompensimi, në përputhje me Kushtet e Kontratës.

Sot, më datë _____ palet bien dakort për nënshkrimin e këtij Formulari Kontrate

si më poshtë:

Neni 1

PËRKUFIZIME

1. “Kontrate” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Subjektit Përfitues të

Shërbimit dhe Ofruesit të Shërbimit që përbehet nga KVK dhe KVK, të gjitha

bashkëlidhjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentet e tjera që përfshihen

në referimin e gdo dokumenti.

2. “Çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Ofruesit të Shërbimit sipas kontratës për

zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontraktore.

3. “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Shërbimet do të sigurojë Ofruesi i Shërbimit

sipas kushteve të kontratës.

4. “Palet (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.





QENDRA KOMBËTARE TEKNIKE BIO-MJEKËSORE TIRANË

“ILLYRIAN GUARD” SHA

5. “Subjekti Përfutur i Shërbimit” do të thotë Autoriteti që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen shërbimin. Ky term kudo që perdoret ka kuptim të njëjtit me atë të përkufizuar në ligj.
6. “Ofrues i Shërbimit” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate shet Shërbimet.
7. “Shërbime” do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Ofruesi i Shërbimit sipas kontratës.

I. OBJEKTI, VLERA, KOHËZGJATJA E KONTRATËS

Neni 2

OBJEKTI I KONTRATËS

Kjo kontratë ka për objekt: “Shërbim Sigurie për ruajtjen fizike të ndërtesave, aseteve dhe njerëzve të Qendrave Kombëtare Teknike Bio-Mjekësore Tiranë, me punonjës shërbimi dhe sistem vëzhgimi dhe sinjalizimi për një periudhë 1 (një) vjeçare”.

Neni 3

ÇMIMI DHE VLERA E KONTRATËS

1. Vlera e përgjithshme e kontratës që përfshin realizimin e shërbimit është si më poshtë:
Vlera mujore e kontratës me 1.18 punonjës shërbimi dhe 1 sistem vëzhgim sinjalizimi dhe shërbim sigurie me 2 akses kontroll me brave elektrike është: 245,348.52 (dyqind dhe shërbim sigurie me 2 akses kontroll me brave elektrike është: 245,348.52 (dyqind e dyzet e pesë mijë e treqind e dyzet e tetë pik pesëdhjetë e dy) Lekë pa TVSH.
Vlera vjetore e kontratës është: $245,348.52 \times 12 = 2,944,182.24$ (dy milion e nëntëqind e dyzet e katër mijë e njëqind e tetëdhjetë e dy pik njëzet e katër) Lekë pa TVSH ose 3,533,018.69 (tre milion e pesëqind e tridhjetë e tre mijë e tetëmbëdhjetë pik gjashhtëdhjetë e nëntë) Lekë me TVSH.
2. Vlera totale e kësaj do të jetë sipas Aneksit Nr.1, pika 3.
3. Efektet juridike dhe financiare të kontratës fillojnë më datë 01.01.2026.

Neni 4

AFATET E PAGESËS

1. Çmimi i kontratës, duke përfshirë çdo pagesë paraprake, duhet të paguhet në kohë sipas specifikohet në kontratë, pas firmosjes së Procesverbalit mujor të kryerjes së shërbimit nga të dy palet sipas Aneksit Nr. 5. Por jo më larg se 30 ditë kalendarike nga lëshimi i faturës (Përfashtohen rastet kur është negociuar që në fillimi një afat tjetër pagesë).





**QENDRA KOMBËTARE TEKNIKE
BIO-MJEKËSORE TIRANË**

“ILYRIAN GUARD” SHA

2. Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa duhet bërë në monedhë Shqiptare. Kursi i shkëmbimit të monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankës së Shqipërisë në ditën kur është dërguar njoftimi i kontratës për botim.
3. Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, kërkesa e ofruesit të shërbimit për pagesë duhet t'i bëhet Përfuturës të Shërbimit me shkrim. Për çdo kërkesë, ofruesi i shërbimit duhet të paraqesë origjinalin dhe kopje së bashku me një listë të sendeve që përshkruan shërbimet e kryera për të cilat duhet paguar.

Neni 5

VONESA NË BËRJEN E PAGESËS

1. Në rast të verifikimit të vonesave mbi 30 ditë kalendrike në kryerjen e pagesave nga ana e përfuturës të Shërbimit, megjithëse ofruesi i shërbimit ka përmbyshur të gjitha detyrimet e tij në përputhje me kushtet e kontratës, ofruesit të shërbimit i lind e drejta për njoftimin e përfuturës të shërbimeve, për detyrimet kundrejt ofruesit të shërbimit. Detyrimet e prapambetura dhe kamat vonesave përkatëse do të kryhen në përputhje me parashikimet e ligjit nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”.

Neni 6

KOHËZGJATJA E KONTRATËS

1. Kohëzgjatja e kryerjes së shërbimit objekti i kontratës do të jetë për një periudhë 12 mujore, **01.01.2026** me përfundim në **31.12.2026**.

II. KUSHTET E KONTRATËS

Kushtet e kontratës, përfshijnë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës (KPK) dhe Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojë mbi KPK.

II.1 KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS

Neni 7

QËLLIMI

1. Kushtet e përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen nga palët kontraktore për blerjen e shërbimit objekti kontrate. Disa dispozita të Kodit Civil janë ri shprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mōhon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil dhe dispozitave të tregut të kësaj kontrate.



QENDRA KOMBËTARE TEKNIKE

BIO-MJEKËSORE TIRANË

1. Dispozita të Ligjit "Për funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike" janë ri shprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike.
2. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike. KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjane kushet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.

HARTIMI I KONTRATËS

Neni 8

1. Ekzistenca e kontratës konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës dhe materializimit të gjitha marrëveshjeve midis palëve.

PRAKTIKAT KORRUPTIVE, KONFLIKTI I INTERESIT DHE KONTROLLI I PROCESVERBALEVE

Neni 9

1. Përfutjesi i Shërbimit mund t'i kërkojë Gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën në se zbulon se Ofruesi i Shërbimit ka kryer veprime korruptive.
2. Ofruesi i Shërbimit duhet të lejojë Subjektin Përfutës të Shërbimit të inspektojë procesverbalet që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontroloreve të emëruar nga Përfutjesi i Shërbimit.

INFORMACIONI KONFIDENCIAL

Neni 10

1. Palët në këtë kontratë duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentet, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.

Neni 11

PËR GJEGJSHMËRIA

1. Ofruesi i Shërbimit garanton përmblotshjen dhe kryerjen e shërbimeve në afatin e duhur dhe në një mënyrë të kujdesshme dhe kompetente në bazë të rregullave dhe standarteve të praktikave me të mira të pranara. Ai është përgjegjës për çdo humbje ose dëm të drejtëpërdrejtë ndodhur ose shkaktuar subjektiv, punonjësve ose përfaqësuesve të tij si rjedhojë e neglizhencës së rëndë, veprimeve dhe mosveprimeve të vullnetshme që bie ndesh me Rregulloren e Brendshme të Sigurisë së Objektivit.





DETYRIMET E PËRGJITHSHME TË KONTRAKTUESIT

Neni 12

1. Ofruesi i shërbimit duhet t'i kryejë shërbimet dhe përmush detyrimet e tij me të gjitha përpjekjet, eficientë dhe ekonomike në pajtim me teknikat dhe praktikat profesionale të pranuar në përgjithësi.
2. Ofruesi i shërbimit duhet të ndjekë praktika të shëndosha të biznesit dhe të përdorë teknologji të avancuar dhe të përshatshme si dhe metoda të sigurta.

DETYRIMET E VEÇANTA TË OFRUESIT TË SHËRBIMIT

Neni 13

1. Ofruesi i shërbimit duhet të kryejë të gjitha shërbimet sipëspecifikohet në këtë kontratë. Ai duhet t'i paraqesë Autoritetit Kontraktues të gjitha shërbimet, në sasi të përcaktuara, sipëspecifikohen nga kontrata duke përfshirë, por jo të kufizuara nga, të gjitha raportet dhe dokumentet.
2. Ofruesi i shërbimit duhet të sigurojë raportet e lidhura me zbatimin e shërbimeve sipëspecifikohet në kontratë.

SKEMA E SIGURISË SË OBJEKTIT

Neni 14

1. Ofruesi i shërbimit duhet të përgatisë skemën e ruajtjes me punonjës shërbimi si dhe të vendosjes së sistemeve, sipas Aneksit Nr. 3.

LEJET DHE LICËNSAT

Neni 15

1. Ofruesi i shërbimit do të jetë përgjegjës për sigurimin e lejeve ose licencave sipas kërkesave të Ligjit Nr. 75/2014 "Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike" për kryerjen e shërbimeve në këtë kontratë veç rasti kur palet bien dakord ndryshe.

HEQJA DHE ZËVENDËSIMI I PERSONELIT KRYESOR

Neni 16

1. Ofruesi i shërbimit do të zëvendësojë çdo punonjës nëse Subjekti Përfutur i Shërbimit zbulon se personi ka kryer veprime të jashtëligjshme.
2. Nëse bëhet e nevojshme të zëvendësohet ndonjë nga personeli kryesor, Ofruesi i shërbimit duhet të sigurojë si zëvendësues një person me kualifikime ekuivalente.





**QENDRA KOMBËTARE TEKNIKE
BIO-MJEKËSORE TIRANË**

Neni 17

VENDNDODHJA

“ILLYRIAN GUARD” SHA



1. Shpërndarja e vendndodhjes së objekteve ku do të ofrohet shërbimi, do të jetë sipas objekteve të parashikuara në tabelat e Aneksit nr.1 bashkëlidhur dhe pjesë integrale e kësaj kontrate. Këto shërbime do të kryhen në vendrojat dhe oraret përkatëse në respektim të tabelës së objekteve dhe rregullores së nënshkruar nga palët.

Neni 18

SIGURACIONI I PËRGJEGJËSISË PROFESIONALE

1. Ofruesi i shërbimit disponon siguracion për përgjegjësi profesionale sipas rregullave dhe praktikave të njohura në përgjithësi për profesionin për ta zhvendësuar Përfutuesin e Shërbimit për dëme të rezultuara nga neglizhenca, gabimet ose mangësitë, në kryerjen e shërbimeve. Polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale mban numër 10222 dhe № serie LIB0004929, me datë lëshimi 28.07.2025, me limit dëmshpërblimi deri në 21,000,000 Lekë, lëshuar nga Shoqëria e Sigurimit “Sigma Interabnian”, me datë mbartimi 28.07.2026. Në përfundim të sigurimit të kontratës në fjalë hyn në fuqi polica e sigurimit pasuese. Polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale rinovohet çdo vit dhe gjatë zbatimit të kësaj kontrate ofruesi i shërbimit ka detyrimin të dërgojë tek përfutuesi i shërbimit formularin e policës së rinovuar për periudhën 2024-2025 dhe 2025-2026 e cila do të jetë pjesë e pandarë e kësaj kontrate.

Neni 19

NRYSHIMI I LIGJEVE DHE RREGULLOREVE

1. Nëse pas datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj, rregullore, urdhëresë, urdhër ose procedurë me efektin e ligjit në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi, nxirret ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit, ose gminin e kontratës, kushtet ose gminin i kontratës do të rregullohen në atë masë sa ofruesi i shërbimit është ndikuar në përmbyshjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

Neni 20

FORCA MADHORE

1. Ofruesi i shërbimit nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e depozitës së kontratës, dëmet e likuiduara ose ndërprerjen për mosplotësim nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në zbatimin e detyrimeve të tij sipas kontratës vijnë si rezultat i ndodhjes së Forcës Madhore.
2. Për qëllimet e këtij neni “Forcë Madhore” do të thotë një ngjarje e paparashikueshme jashtë kontrollit të Ofruesit të Shërbimit mbi fajin ose neglizhimin. Ngjarje të tilla mund





te përfshijnë, por nuk janë të limituara nga, veprimet e Përfutjesit të Shërbimit qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmblytja, tërmeti, epidemite, shtrengime të karantinës dhe embargo transiti.

3. Në se ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, Ofruesi i shërbimit duhet të njoftojë menjëherë Subjektin përfutës të shërbimit. Me përjashtim kur ky i fundit jep direktiva të ndryshme, Ofruesi i Shërbimit duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjeket e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.

Neni 21

VONESA NË ZBATIM DHE ZGJATJA E AFATIT

1. Me përjashtim kur parashikohet ndryshe, Ofruesi i shërbimit duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj.

2. Subjekti Përfutës i Shërbimit mund të zbrisë shumën e dëmeve të likuiduara që duhet paguar nga shuma e pagesës ndaj ofruesit të shërbimit. Në rast të tillë Përfutësi i shërbimit duhet t'i japi kontraktuesit njoftim me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes.

3. Subjekti Përfutës i Shërbimit do të jetë dakort për një zgjatje të afatit në rastin e Forcës Madhore.

4. Subjekti Përfutës i Shërbimit mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera nëse është në interesin publik për ta bërë këtë. Ofruesi i shërbimit duhet të njoftojë menjëherë përfutësit e shërbimit me shkrim për vonesën, shkakun dhe datën e propozuar të përfundimit të Shërbimeve. Ky autoritet duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga palet.

Neni 22

LIKUIDIMI I DËMEVE PËR DORËZIMIN E VONUAR

1. Dëmet e likuidueshme për kryerjen e vonuar të Shërbimeve do të llogariten me tarifën e mëposhtme ditore:

a. Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga gnumi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.

b. Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga gnumi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.





9

1. Kontrata do të interpretohet sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE

Neni 26

- 1. Subjekti Përfutës i Shërbimit mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse Ofruesi i Shërbimit falimenton.
- 2. Subjekti Përfutës i Shërbimit duhet t'i japë Ofruesit të Shërbimit njoftim me shkrim për ndërprerjen sipas nje afati 30 ditor.

NDËRRPRERJA PËR SHKAK TË FALIMENTIMIT

Neni 25

- 1. Subjekti Përfutës i Shërbimit mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:
 - a. Ofruesi i Shërbimit dëshon të kryejë shërbimet brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë; ose,
 - b. Ofruesi i Shërbimit dëshon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.
- 2. Përfutës i Shërbimit duhet t'i japë ofruesit të shërbimit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe t'i japë atij 30 ditë të ndreqë mosplotësimin.
- 3. Ofruesi i Shërbimit mund të ndërpresë kontratën nëse Përfutësi i Shërbimit nuk likuidon faturën për një afat 45 ditor.

NDËRRPRERJA PËR MOSPLOTËSIM

Neni 24

- 1. Asnjë amendament ose variation tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qenë me shkrim, me datë, t'i referohet shprehimisht kontratës dhe nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar i të dy palëve.
- 2. Çdo heqje dore nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palet sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqësues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.

NEGOCIATAT DHE AMENDAMENTET

Neni 23

- c. Për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga gëimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.

**QENDRA KOMBËTARE TEKNIKE
BIO-MJEKËSORE TIRANË**

"ILYRIAN GUARD" SHA





**QENDRA KOMBËTARE TEKNIKE
BIO-MJEKËSORE TIRANË**

Neni 27

ZGJIDHJA E MOSMARRVESHJEVE

1. Palet kontraktore duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrëveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrëveshje me negociata direkte.
2. Nëse palet dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes ose konfliktit, problemet do të konsiderohen me anë të zgjidhjes së marrëveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 28

PËRFAQËSIMI I PALEVE

1. Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose post organizativ, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në gëshjet e lidhura me ekzekutimin e kontratës.

Për Përfutjesit e shërbimit person përgjegjës do të jetë Z. Ismail Garipi, me nr. kontakti: 067 729 3894 me adresë e-mail: Ismail.Garipi@biomedical.gov.al

Për Ofruesin e shërbimit person përgjegjës do të jetë Z. Fatos Saja, Elda Prekazi me adresë e-mail: info@illyrianguard.al / Kontratata@illyrianguard.al me nr. kontakti: 0682031040, 0692301184.

2. Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfutjesit të palës. Nëse njëra palë dëshon të lajmërojë, duhet të marrë përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të menjtueshëm.
3. Palet mund të emërojnë persona ose njësi organizative shtesë për të përfaqësuar palën në veprimet ose veprimtari të veçanta njoftimi me shkrim në të cilin rast duhet dhënë dhe duhet të përcaktojnë shtrirjen e autoritetit të përfaqësuesit.

Neni 29

LAJMËRIMET

1. Çdo lajmërim i dhënë nga njëra palë tjetër sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën postare fizike të specifikuar në kontratë.
2. Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

Neni 30

LLOGARITJA E AFATËVE

1. Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike me përjashtim kur parashtohet





Kushtet e veçanta të mëposhtme të Kontratës do të plotësojnë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës. Në rast se ka mospërputhje midis KPK dhe KVK do të mbizotërojnë ato të Kushteve të veçanta të Kontratës.

Neni 31

VENDNDODHJA E SHËRBIMEVE

1. Shërbimet do të kryhen sipas shpërndarjes në preventivin dhe tabelën e vendrojeve/objekteve të pasqyruar edhe në rregulloren e nënshkruar dhe të pranuar nga palet (Aneksi Nr.1), si dhe skemën/at e ruajtjes së objektit/eve (Aneksi Nr.3).
2. Shërbimet që do të realizohen janë përcaktuar në tabelën e shërbimeve në objektet në ruajtje.

Neni 32

DETYRIMET E OFRUESIT TË SHËRBIMIT

1. Ofruesi i shërbimit do të ruajë dhe sigurojë nëpërmjet vlerësimit dhe përcaktimit të masave të sigurisë si më poshtë:
 - 1.1 Analiza e sigurisë fizike të objekteve
 - 1.2 Sistemi i sinjalizimit/alarmit sipas zonave sensitive dhe perimetrit të objektit
 - 1.3 Sistemi i vëzhgimit me kamera
 - 1.4 Sistemi i komunikimit me radio dhe telefon
 - 1.5 Operatore për monitorim të drejtpërdrejtë dhe të pandërprerë të kamerave
 - 1.6 Grup i gatshëm i cili aktivizohet në rast nevoje
 - 1.7 Thirrje e emergjencës
2. Detyrat specifike të ofruesit të shërbimit do të vendosen në Rregulloren e Përbashkët të Sigurisë, e cila është pjesë integrale dhe e pandarë e kësaj kontrate.

Neni 33

INFORMACION QË DUHET DHËNË NGA PËRFITUESI I SHËRBIMIT

1. Përpapara lidhjes së kontratës Përfituesi i Shërbimit duhet t'i japë Ofruesit të Shërbimit informacionin dhe dokumentet e mëposhtme:
 - a) Informacionin mbi shpërndarjen gjeografike të objekteve;
 - b) Si dhe çdo informacion e dokument tjetër të nevojshëm të cilat i shërbejnë realizimit të objektit të kontratës.





MËNYRA E EKZEKUTIMI
Neni 34

1. Sipas Udhezimit të Përbashkët të Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë, objektet e kësaj kontrate cilësohen si objekte të Kategorisë I sipas kategorizimit. Mënyra e kryerjes së shërbimit do të realizohet sipas pikës 3.2 të këtij Udhezimi në të cilin është parashikuar kryerja e shërbimit të alternuar me sisteme elektronike të sigurisë dhe me punonjës shërbimi të ruajtjes fizike.

2. Instalimi dhe vënia në funksion e sistemeve elektronike ku përfshihen sisteme elektronike/ sisteme alarmi dhe vëzhgim me kamera do të realizohet brenda 3 (tre) muajve nga data e nënshkrimit të kontratës. Në mungesë të sistemeve elektronike të sigurisë, nga data e nënshkrimit të kontratës deri në vënien në funksion të sistemeve elektronike, shërbimi për sigurinë e objekteve do të kryhet me punonjës shërbimi të ruajtjes fizike për të gjitha objektet dhe për të gjitha. Ky shërbim do të kryhet nga ofruesi i shërbimit brenda gnumit të përcaktuar në këtë kontratë. Gjatë gjithë kësaj periudhe, ofruesi i shërbimit merr përsipër të kryejë ruajtjen e të gjitha objekteve me punonjës shërbimi të certifikuar, për të gjitha turnet, deri në vënien në funksion të sistemeve elektronike/alarmit.

RREGULLORE E BRENDSHME E SIGURISË SË OBJEKTT
Neni 35

1. Mënyra e organizimit dhe kryerjes së shërbimit, përgjegjësitë e palëve për sigurinë e objekteve, detyrat e përgjithshme dhe veçanta të punonjësve të shërbimit, përcaktohen në kontratë. Ajo hartohet nga të dy palët dhe përfshin të gjitha rregullat e nevojshme për rregulloren e shërbimit të sigurisë të nënshkruar nga të dy palët dhe është pjesë e kësaj rregullore e shërbimit të sigurisë së objektit duke qenë e detyrueshme për personelin e të dy palëve.

TE DREJTAT DHE DETYRIMET E OFRUESIT TË SHËRBIMIT
Neni 36

1. Ofruesi i Shërbimit do të kryejë Shërbimin në përputhje me legjisllacionin në fuqi, Ligjin nr.75/2014 “Për shërbimin Privat të Sigurisë Fizike” i ndryshuar si dhe temat e vendosura në Rregulloren Brendshme të Sigurisë së Objektit.
2. Ofruesi i Shërbimit do të pajtohet me të gjitha rregullat e Subjektit përfitues lidhur me përmblushtjen e shërbimit të cilat nuk bien ndesh me Rregulloren e Brendshme të Sigurisë së Objektit.



**QENDRA KOMBËTARE TEKNIKE
BIO-MJEKËSORE TIRANË**

“ILLYRIAN GUARD” SHA

3. Otruesi i Shërbimit do të kryej shërbimet në mënyrë tërësisht profesionale dhe kompetente, duke përdorur të gjitha mjeket e mundshme, përfshirë burimet mjekësore, pajisje dhe aparatura të tjera me qëllim përmirësimin e shërbimit, duke respektuar të gjitha termat dhe kushtet e përcaktuara në këtë kontratë në **Rregulloren e Brendshme të Sigurisë së Objektivit**, si dhe duke plotësuar në mënyrë të kënaqshme të gjitha kërkesat e Subjektivit.

4. Otruesi i Shërbimit do të garantojë një staf profesional, i adoptueshëm me të gjitha rregullat e Rregullores së Brendshme të Sigurisë së Objektivit, Kodin e Etikës si dhe urdhëresat e tjera që vendosen në objekt duke garantuar një mjedis dhe kushte pune të sigurta.

5. Në rastet kur shërbimi është me sistem, Otruesi i Shërbimit merr përsipër montimin e sistemit të kamerave, sistemit të alarmit dhe akses kontrollit sipas skemës së dakortësuarara midis palëve. Në rastet kur sistemet elektronike pësojnë defekt për arsye të fatkeqësive natyrore, defekte të rënda të energjisë elektrike, thyerje, dëmtim rrjeti, shërbime teknike, ndryshim të sistemeve ose në rastet kur është marrë shërbimi dhe montimi i sistemeve është në proces. Kontraktori menjëherë organizon shërbimin me punonjës shërbimi gjatë 24 orëve deri në momentin e vendosjes së sistemit elektronik në gatisshmëri.

6. Personeli i shpërndarë do të kryej detyrat në përputhje me orarin e punës për të cilën palët kanë rënë dakort paraprakisht, duke marrë parasysh përparësinë e kryerjes së shërbimeve. Të gjitha shpenzimet lidhur me blerjen e pajisjeve të nevojshme për kryerjen e shërbimeve do të mbulohen nga Otruesi i shërbimit. Të gjitha pajisjet dhe aparaturat që janë blerë nga Otruesi i Shërbimit konsiderohen pronë e tij dhe rast të përfundimit ose ndërprerjes së kësaj kontrate këto pajisje dhe aparatura do të merren nga Otruesi i Shërbimit

7. Otruesi i shërbimit disponon një Qendër Kontrolli të Shërbimit (Sallë Operative) me adresë : Rr “Ibrahim Rugova ”, Ish Garda Republikës Shqipërisë, Tiranë. Ajo është e pajisur me sistem ndërlihdhës, radio komunikim, radio alarm që bëjnë të mundur sigurimin e pandërprerë të ndërlihdhjes pranë çdo objekti.

8. Otruesi i shërbimit disponon mjete logjistike përkatëse të parashikuara nga ligji për kryerjen me sukses të shërbimit si automjete, motore si dhe në çdo moment do të ketë në dispozicion grupe të gatshme për ndërhyrje në situatat emergjente apo ngjarje kriminale si vënie në rrezik të jetëve mjekësore, aseteve, ndërtesave e dëmtime të bazës materiale dhe objekteve të rëndësishme të vendit.





TE DREJTAT DHE DETYRIMET E PËRFITUESIT TË SHËRBIMI

Neni 37

1. Subjekti, Qendra Kombëtare Teknike Bio-Mjekësore Tiranë, pranon kryerjen e të gjitha shërbimeve nga Ofruesi i Shërbimit “Illyrian Guard” Sha sipas të gjitha përcaktimeve të specifikave të përfshira në Rregulloren e Përbashkët të Sigurisë së Objektivit.

2. Subjekti do të bashkëpunojë me Ofruesin e Shërbimit kur rezultoni e nevojshme për kryerjen e shërbimeve, në bazë të kërkesës së këtij të fundit ose me iniciativë të vetë Subjektit.

3. Subjekti duhet të sigurojë vendin e punonjësit të shërbimit (ambient shërbimi), ndriçim, energji dhe internet të pandërprerë për pajisjet dhe sistemet e vendosura.

4. Subjekti nuk duhet të ndërhyjë në asnjë mënyrë në pajisjet dhe sistemet e vendosura përveçse në rastet e parashikuara në Rregulloren e Përbashkët të Sigurisë së Objektivit.

5. Subjekti duhet të dëmshpërblejë pajisjet në rast dëmtimi nga ana e tij sipas akteve ligjore në fuqi.

6. Subjekti do të kryejë pagesën e tarifës së shërbimit Ofruesit të Shërbimit sipas dispozitave përkatëse të Kontratës kundrejt kryerjes së shërbimeve të dokumentuara çdo muaj në procesverbal nga Ofruesi i Shërbimit sipas kësaj Kontrate nga ky i fundit (Aneksi nr. 5).

7. Refuzimi i Subjektit për të pranuar ndonjë nga shërbimet, nuk heq detyrimin e tij për të paguar tarifën e shërbimit. Ky rregull zbatohet edhe në rast kur Subjekti nuk i përdor shërbimet ose ka vazhduar të mos i përdorë ato, përveç rasteve kur një mospërdorim i tillë ka ardhur për faj të Ofruesit të Shërbimit.

Neni 38
KËRKESAT E RAPORTIMIT

1. Gjatë realizimit të kontratës, Ofruesi i Shërbimit së bashku me faturen mujore duhet të paraqesë Procesverbalin e kryerjes së shërbimit, sipas Aneksit Nr.5, i cili do të nënshkruhet nga të dy palët.

2. Ky procesverbal do të konfirmohet nga përfaqësuesi i Përfituesit të Shërbimit dhe përfaqësuesi i Ofruesit të Shërbimit.

3. Në rast se gjatë zbatimit të kësaj kontrate, përfituesi i shërbimit do të duhet të mbyllë aktivitetin në ndonjë nga objektet e tij, duhet të njoftojë me shkrim ofruesin e shërbimit brenda një afati 30 ditë. (Parashikimi i zhdëmtimit për investimin e realizuar nga shoqëria).

4. Pagesa që do të takojë Ofruesit të Shërbimit do të jetë në përputhje me ditët e shërbimit të dhënë në atë objekt, sipas konfirmimit të përfaqësuesve të palëve në këtë kontratë.





**QENDRA KOMBËTARE TEKNIKE
BIO-MJEKËSORE TIRANË**

Neni 39

KUSHTET E PAGESËS

“ILLYRIAN GUARD” SHA



1. PAGESA për Shërbimet do të bëhet me urdher xhirim, sipas formateve të miratuara për këtë qëllim. Data e pagesës do të jetë dita që fondet xhironen nga llogaria e **Qendra Kombëtare Teknike Bio-Mjekësore Tiranë**. Pagesa e shërbimeve do të bëhet deri në 30 ditë kalendarike nga data e dorëzimit të faturës tatarore e cila duhet të shqërohet me këtë dokumentacion: Listë e objekteve ku ofrohet shërbimi sipas Aneksit nr.1, situacionet për shërbimet e kryera në fakt të nënshkruara nga përfaqësuesit e të palëve.

2. Monedha e pagesës do të jetë monedha Shqiptare “Leke”. Kjo pagesë do të bëhet në Bankën Intesa San Paolo Bank, Nr.Llogarisë: 29042331101, IBAN: AL 3320811008000029042331101, Bankën CREDINS Bank, Nr. Llogarisë: 00001205982, IBAN: AL 80 2121 1009 0000 0000 0120 5982.

Neni 40

GARANCIË

1. Ofruesi i Shërbimit garanton si më poshtë:

- Kryerjen e shërbimeve me kujdes të arsyeshëm dhe zotësi në zbatim të Ligjit 75/2014, dt. 14.07.2014 i ndryshuar, Udhëzimi Nr.150 datë 16.08.2024 të Ministrit të Brendshëm “Për funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike”, VKM-së nr. 177, datë 04.04.2019, Udhëzimit të Përbashkët të Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 90, dt. 27.06.2023.
- Kryerja e shërbimeve në zbatim të kësaj Kontrate do të pajtohet me temat, kushtet dhe specifikat e përfshira në **Rregulloren Brendshme të Sigurisë së Objektivit** bashkëngjitur kësaj Kontrate.
- Gjatë kryerjes së Shërbimit, Ofruesi i Shërbimit duhet të veprojë në interesin më të mirë të Përfuturës së Shërbimit, Ai garanton që punonjësit e tij do të karakterizohen nga një sjellje korrekte dhe do të pranojnë dhe zbatojnë kërkesat e legjisllacionit shqiptar mbi shëndetin dhe sigurinë në punë.
- Të gjitha pajisjet e destinuara për kryerjen e shërbimeve duhet të jenë cilësore, në dispozicion dhe të përdoren nga një personel dhe i përgjegjshëm. Ky rregull vlen dhe për pajisje shtesë, të cilat Ofruesi i shërbimit ka për qëllim ti përdorë për përmirësimin e shërbimeve.
- Përfuturës i Shërbimit duhet të bashkëpunojë me korrektësi me personelin e Ofruesit të Shërbimit. Ai duhet të kryejë kushte të përshtatshme për kryerjen e shërbimit nga pala kontraktore.





Administrator

Enrik BANUSHI

“ILLYRIAN GUARD” SHA



Drejtor

Luan Kola

QENDRA KOMBËTARE TEKNIKE
BIO-MJEKËSORE TIRANË

PALET KONTRAKTORE

U nënshkrua në Tiranë, sot më datë _____.

1. Kjo Kontratë pranohet me të gjitha kushtet dhe temat e saj. Ajo do të rregullohet, interpretohet dhe zbatohet në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.
2. Kjo kontratë hartohet në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe, ekzemplare me përmbajtje të njëjtë, ku 2 (dy) kopje janë për Përfituesin e Sherbimit dhe 2 (dy) kopje për Ofruesin e Sherbimit. Çdo kopje ka të njëjten përmbajtje dhe të njëjten vlerë ligjore.
3. Pallet pasi e lexojnë, kuptojnë dhe pranojnë përmbajtjen e kontratës, me vullnetin e tyre të lirë e nënshkruajnë atë.

DISPOZITAT E FUNDIT

Neni 41

“ILLYRIAN GUARD” SHA

QENDRA KOMBËTARE TEKNIKE
BIO-MJEKËSORE TIRANË



**QENDRA KOMBËTARE TEKNIKE
BIO-MJEEKËSORE TIRANË**



“ILLYRIAN GUARD” SHA



Aneksi nr. 1

1. Tabela e objekteve ku ofrohet shërbimi për Qendra Kombëtare Teknike Bio-

Mjekësore Tiranë.

2. Rregulloret e Përbashkët e Sigurisë së Objektivit.

3. Mënyrat e llogaritjes së tarifës referuar Udhëzimit Nr.90 “Për mënyrën e përlllogaritjes së tarifave të shërbimeve specifike, nga shogëria

së tarifave të shërbimeve specifike, që u ofrohen subjekteve publike, nga shogëria “Illyrian Guard” Sh.A”.

1. Tabela nr. 1

Objektet në ruajtje për llogari të Qendres Kombëtare Teknike Bio-Mjekësore Tiranë.
- Godina e Qendres Kombëtare Teknike Bio-Mjekësore Tiranë.

2. Rregulloret e Përbashkët e Sigurisë së Objektivit.

3. Mënyrat e llogaritjes së tarifës referuar Udhëzimit Nr.90 “Për mënyrën e përlllogaritjes së tarifave të shërbimeve specifike, që u ofrohen subjekteve publike, nga shogëria “Illyrian Guard” Sh.A”.

Qendra Kombëtare Teknike Bio-Mjekësore

Nr.	V.Roje	Turnet	Koha e ruajtjes	Koef.	Nr i rojeve	Tarifa pa TVSH Mujore 1 roje/ 1 sistem	Vlera Totale Mujore pa TVSH	Vlera Totale 12 mujore pa TVSH	Vlera Totale 12 mujore me TVSH
1	1	1	8,5 ore(08:00:16:30) e Henë e Enjte (08:00-14:00) te Premten	1.18	1.18	76,014.00	89,696.52	1,076,358.24	1,291,629.89
2			sistem vezhgimi sinjalizimi NVR 8 kanale 7 kamera dhe alarm			148,400.00	148,400.00	1,780,800.00	2,136,960.00
3			2 shërbime sigurie me akses kontroll dhe brave elektrike			3,626.00	7,252.00	87,024.00	104,428.80
Totali						1.18	245,348.52	2,944,182.24	3,533,018.69



KONTRATË PËR PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE NGA
“ILLYRIAN GUARD” SHA

Neni 1
Qëllimi

E lidhur sot me datë ____ . ____ . ____ midis palëve:

Qendra Kombëtare Teknike Bio-Mjekësore Tiranë, me adresë: Rruga "Dibrës", Nr.12, Tiranë, me NIPT K51731023B, përfaqësuar nga Z. AIDO QEVJANI në cilësinë e Drejtorit të Komanduar, tani e tujtë të referuar si "Përfutues i Sherbimit" dhe

"Shogëria "Illyrian Guard" sh.a., me NIPT: L91619024U, me adresë: Rr "Ibrahim Rugova", Ish Garda Republikës Shqiptare, Tiranë, e cila është e organizuar dhe ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislaacionin Shqiptar e Regjistruar pranë Qendres Kombëtare të Regjistrimit, përfaqësuar nga Administratori i saj Z. ENRIK BANUSHI, në cilësinë e Përpunuesit;

me qëllim që të ofrojë një mbrojtje të mjaftueshme në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave personale nga Kontrolluesi me seli në Shqipëri tek përpunuesi me seli në, me qëllim përpunimin e këtyre të dhënave për llogari të Kontrolluesit.

Kjo kontratë zbatohet për të gjitha të dhënat personale të cilat delegohen për t'u përpunuar nga Kontrolluesi tek Përpunuesi dhe që përpunohen nga Përpunuesi për llogari të Kontrolluesit.

Neni 2
Përkufizime

1. Të gjithë termat e kësaj kontrate kanë të njëjtin kuptim si ato të përkufizuar në Ligjin 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, përveç rasteve të përcaktuara shprehimisht ndryshe.
2. Për qëllimet e kësaj kontrate termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

"Kontrolles" është çdo person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci, kompani, organizatë apo institucion që mban, administron dhe kontrollon të dhëna personale dhe për me një kompani të tretë e cila në këtë rast quhet përpunuesi.





“Përpunues” është ajo kompani e tretë e cila hyn në një marrëdhënie kontraktore me kontrolluesin me qëllim përpunimin e të dhënave personale me kosto më të ulët për llogari të kontrolluesit;

“Cënimi i të dhënave personale” është prekje e sigurisë së të dhënave që rezulton në shkatërrimin, humbjen, ndryshimin, përhapjen e pa-autorizuar ose ndërhyrjen te të dhënat personale të transmetuara, ruajtura apo përpunura.

Neni 3

Detyrimet e Kontrolluesit

1. Kontrolluesi garanton që të dhënat personale që delegohen për përpunim janë mbledhur dhe përpunuar në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kontrolluesi garanton që delegimi i përpunimit të këtyre të dhënave te përpunuesi është në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Kontrolluesi është i detyruar që:

a) Përpara se të delegojë përpunimin e të dhënave personale të njoftojë subjektet e të dhënave në lidhje me këtë delegim, si dhe qëllimin e këtij delegimi;

b) Përpara se të delegojë përpunimin e të dhënave të informojë Komisionerin për Mbrojtjen e të dhënave Personale sipas dispozitave të Ligjit 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i ndryshuar;

c) Të verifikojë masat teknike dhe organizative të ndërmarra nga Përpunuesi që sigurojnë mbrojtjen e mjaftueshme të të dhënave personale.

Neni 4

Detyrimet e Përpunuesit

1. Përpunuesi është i detyruar që të përpunojë të dhënat personale të marra nga Kontrolluesi dhe çdo të dhënë tjetër që rrjedh prej këtij përpunimi:

a) Vetëm për llogari të Kontrolluesit dhe për qëllimet e përcaktuara nga Kontrolluesi;

b) Sipas udhëzimeve të Kontrolluesit; dhe

c) Në përputhje me këtë Kontratë.

2. Përpara fillimit të përpunimit Përpunuesi merr të gjitha masat teknike dhe organizative për të mbrojtur të dhënat personale të dërguara nga Kontrolluesi nga çdo përpunim i paautorizuar, duke përfshirë shkatërrimin, humbjen, përhapjen e paligjshme apo dëmtimin e tyre.

3. Përpunuesi njofton menjëherë Kontrolluesin në rastet kur:

1. Është në pamundësi të vazhdojë zbatimin e kësaj kontrate; ose

2. Ka ndodhur një prekje aksidentale apo a pa-autorizuar e të dhënave personale.





**QENDRA KOMBËTARE TEKNIKE
BIO-MJEKËSORE TIRANË**

“ILLYRIAN GUARD” SHA



4. Përpunuesi nuk nënkontraktton kompani të treta për të bërë përpunimin e të dhënave pa miratimin paraprak me shkrim të Kontrolluesit.

Neni 5

Nënkontraktimi

1. Në rast të nënkontraktimit, Përpunuesi është i detyruar të sigurojë që:
a) Ka informuar paraprakisht Kontrolluesin dhe ka marrë miratimin e tij me shkrim;
b) Nënkontraktimi i përpunimit bëhet vetëm për veprimet të rena dakord në këtë kontratë;
c) Përpunuesi dhe Nënkontraktuesi firmosin kontratë sipas së cilës Nënkontraktuesi ka të njëjtat detyrimet si ato të Përpunuesit sipas kësaj kontrate;
d) Një kopje e kontratës së nënkontraktimit i dërgohet Kontrolluesit.

2. Në rast se Nënkontraktuesi nuk i përmbush detyrimet sipas kësaj kontrate, përgjegjësia për cënimin e të dhënave mbetet e Përpunuesit, sipas përcaktimeve të kësaj kontrate.

3. Kontrolluesi ka të drejtën që në çdo kohë të kontrollojë respektimin e kësaj kontrate nga ana e Përpunuesit, ose të kërkojë që ky kontroll të bëhet nga një palë e tretë e kualifikuar. Në këtë rast Përpunuesi ofron bashkëpunimin e plotë dhe shpenzimet e kontrollit mbulohe nga Kontrolluesi. Në rast se nga kontrolli rezulton se Përpunuesi nuk ka vepruar sipas kësaj kontrate, shpenzimet e kontrollit mbulohe nga Përpunuesi.

Neni 6

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve midis palëve në kontratë mund të arrihet me mirëkuptim. Në rast të kundërt palët i drejtohen gjykatës kompetente.

Neni 7

Sanksionet

Në rast të mospërmbushjes së detyrimeve të palëve të përcaktuara në këtë kontratë zbatohen sanksionet e parashikuara në legjislacionin në fuqi.

Neni 8

Afatet dhe përfundimi i kontratës

1. Kohëzgjatja e kësaj kontrate është e përcaktuar dhe e kushtëzuar me kohëzgjatjen e përcaktuar në Nenin 10 të “*Kontrates së Shërbimit*” me Nr. _____, dhe Nr. _____ të datës ____/____/____ të lidhur midis palëve.

2. Secila prej palëve mund ta përfundojë këtë kontratë para afatit.





**QENDRA KOMBËTARE TEKNIKE
BIO-MJESËSORE TIRANË**

3. Pas përfundimit të kësaj kontrate Përpunuesi:

- a) I kthen menjëherë Kontrolluesit gdo të dhënë personale dhe kopje të tyre të dërguara nga Kontrolluesi, si dhe ato që kanë rrjedhur prej përpunimit;
- b) Në rast se ky kthim është i pamundur, Përpunuesi shkatërron gdo të dhënë personale dhe gdo kopje dhe njofton menjëherë Kontrolluesin me shkrim;
- 4. Në gdo rast Përpunuesi është i detyruar të ruajë konfidencialitetin e të dhënave personale të përpunuar apo të dhënave që kanë rrjedhur prej këtij përpunimi.

Neni 9

Dispozita të fundit

- 1. Kjo kontratë hartohet në 3(tre) kopje të njëjta. Një kopje e kësaj kontrate i vihet në dispozicion Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale menjëherë pas nënshkrimit,
- 2. Të drejtat dhe detyrimet e palëve në këtë kontratë nuk çenohen apo ndikohen në të drejtat dhe detyrimet që u burojnë këtyre palëve nga kontrata të tjera, apo nga legjislatiomi në fuqi.
- 3. Kjo Kontratë mund të ndryshohet vetëm me shkrim.

Për:

**QENDRA KOMBËTARE TEKNIKE
BIO-MJESËSORE TIRANË**

Luan Kola

Drejtor

“ILYRIAN GUARD” SHA

Enrik BANUSHI

Administrator



“ILYRIAN GUARD” SHA

Aneksi nr. 3 - Skema e Sigurisë së Objektivëve

QENDRA KOMBËTARE TEKNIKE
BIO-MJEKËSORE TIRANË



“ILYRIAN GUARD” SHA





**QENDRA KOMBËTARE TEKNIKE
BIO-MJEKËSORE TIRANË**

Aneksi nr. 4 - Proces Verballi i marrjes së objekteve në dorëzim me fillimin e zbatimit të kontratës

Tiranë, ____ / ____ / ____

Proces Verballi

Për marrjen dhe dorëzimin në ruajtje të objektit _____.

Objekti merret në dorëzim për ruajtje prej orës ____ : ____ dt. ____ / ____ / ____.

Objekti merret në ruajtje sipas Kontratës së dakortësuar ndërmjet _____ dhe "Illyrian Guard" sha. Ruajtja do të bëhet me _____ (organizimi i shërbimit).

Objekti u kontrollua nga dorëzuesit dhe marrësit në ruajtje. Nuk ka probleme në objekt. Ndërtuesat e Institucionit janë të mbyllura. Vendrojet e qëndrimit të punonjësve të shërbimit janë të rregullta për kryerjen e detyrës.

Ky proces verbal mbahet në tre kopje, nga një për çdo përfaqësues.

Processverballi firmoset nga tre përfaqësues:

Marrësi

Illyrian Guard sha

Emër Mbiemër _____

Dorëzuesi

Emër Mbiemër _____

Institucioni

Qendra Kombëtare Teknike
Bio-Mjekësore Tiranë

Emër Mbiemër _____



"ILLYRIAN GUARD" SHA

